



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 70 dt.20.07.2001

**PER  
REALIZIMIN E PROJEKTIT “NDERTIMI I MURIT RRETHUES TE PARKUT  
RINIA DHE PARKUT TE MADHE”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Financimin e projektit, “Ndërtimi i murit rrethues të parkut “Rinia” dhe “Ndërtimi i Murit rrethues të Parkut të madh në Rr. E Elbasanit” në shumën totale prej 11.936.244 lekësh
2. Fondi total prej 11.936.244 lekë të përballohet nga zëri “Ndërtim i Urës që lidh 2 segmentet në Bulevardin “Dëdhmorët e Kombit”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



